



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**KULTURA E PËRGJITHSHME PËR SHKOLLAT ME DREJTIM TË  
ORIENTUAR  
ARSIMI I MESËM I LARTË**

**DEGA: FUTBOLL DHE ATLETIKË, GJIMNASTIKË, LOJËRA, SPORTE TË  
RËNDA  
LËNDA: GJUHË E HUAJ E PARË**

**KLASA: XI**

Tiranë, 2017

## PËRMBAJTJA E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ”

1	HYRJE .....	3
2	KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ” .....	5
2.1	Qëllimet e programit lëndor “Gjuhë e huaj” .....	8
2.2	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj” .....	10
2.3	Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës “Gjuhë e huaj” .....	14
2.4	Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me temat ndërkurrikulare .....	21
2.5	Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare .....	22
2.6	Kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj” .....	24
2.7	Rezultatet e të nxënit .....	26
2.8	Ndarja e orëve mësimore.....	37
3	UDHËZIME METODOLOGJIKE.....	39
4	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN.....	41

## HYRJE

Lënda “Gjuhë e huaj” (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht) synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësit. Më konkretisht, lënda ‘Gjuhë e huaj e parë’, e aftëson nxënësin në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tij personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të botës së punës.

Mësimi i gjuhës amtare, i letërsisë dhe i gjuhëve të huaja e ndihmon nxënësin të bëhen individ i pavarur, i lirë, i kulturuar, mendimtar kritik dhe krijues, si dhe i vetëdijshëm për identitetin e tij personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të huaj), nxënësi zhvillon botën e tij emocionale, pasuron përfytyrimet dhe imagjinatën e tij për botën, çmon dhe vlerëson gjuhët dhe kulturën kombëtare e botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësit për t’u bërë komunikues i mirë, lexues aktiv e i pavarur dhe shkruar i saktë, origjinal dhe krijues.

Lënda ‘Gjuhë e huaj’ përbëhet nga “Gjuhë e huaj e parë” dhe “Gjuhë e huaj e dytë”.

**Gjuha e huaj e parë** fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

**Gjuha e huaj e dytë** fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII). Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha gjermane, gjuha angleze.

**Kompetencat** përcaktohen si njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që nxënësi duhet t’i fitojë gjatë procesit mësimor.

**Njohuri** është një e vërtetë e arsyetuar dhe e provuar sipas kritereve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike e ato shkollore apo në vepra të specializuara si produkt i një ose disa dijetarëve apo praktikienëve, ndërtim mendor i realizuar nga personi gjatë bashkëveprimit me mjedisin ose nga vetëreflektimi për t’u bërë pjesë e trashëgimisë njohëse të tij, si p.sh., njohuri për llojet e teksteve, njohuri gramatikore, njohuri për hartimin e një prezantimi etj.

**Shkathësi** është një kapacitet (mendor/fizik) i fituar për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës dhe energjisë, ose të të dyjave bashkë. Shkathësia mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë, si: të kuptuarit, të interpretuarit, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese, zgjidhja e problemeve etj.

**Qëndrimet** janë një mënyrë e përcaktuar e të menduarit, opinioneve dhe ndjenjave ndaj diçkaje, një ideje, personi ose situatë dhe që ndikojnë në sjelljen e individit. Qëndrimet ndikohen nga njohuritë dhe vlerat dhe janë zakonisht shkaktare të sjelljeve (edhe pse lidhjet mes qëndrimeve dhe sjelljeve nuk janë drejtvizore).

**Vlerat** janë bindje që ruhen thellë lidhur me çfarë është e rëndësishme ose e dëshirueshme. Ato shprehen nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave. Disa vlera dhe qëndrime janë respektimi i rregullave të etikës gjatë të folurit, shmangia e fyerjeve dhe paragjytimeve, shpirti i iniciativës, serioziteti, vetëbesimi etj.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë nivel arsimit nxënësi është pajisur me njohuritë, shkathësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën, shoqërinë dhe për botën e punës. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësi has sfida të reja dhe përdor aftësitë gjuhësore të fituara gjatë shkollimit për të reaguar në situata të njohura dhe jo të njohura për të si në klasë/shkollë ashtu edhe jashtë saj duke mbajtur qëndrime dhe zhvilluar vlera.

## KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ”

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i kulturës së përgjithshme për Arsimin e Mesëm të Orientuar- shkollat artistike dhe sportive.

Programi shoqërohet me udhëzues dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve dhe të hartuesve të teksteve mësimore.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

**Mësuesit** do ta përdorin programin e gjuhës së huaj për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të nxjehë nxënësi dhe se si duhet të ndërtojë mësimdhënien për të pajisur nxënësin me kompetencat kyçe dhe ato të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit. Ky program i ndihmon mësuesit të reflektojnë mbi praktikën e tyre të mësimdhënies dhe të koordinojnë punën dhe përpjekjet e tyre për të përmbushur nevojat e nxënësit në të kuptuarin e lëndës dhe përdorimin praktik të saj edhe jashtë ambjentëve shkollorë, pasi mësuesit janë modele të cilat nxënësi ndjek në të ardhmen. Mësuesit do ta përdorin këtë program për të përcaktuar e monitoruar objektivat e vendosura për t'u përmbushur nga nxënësi në klasë, në shkollë si edhe në një raport më të gjërë.

**Autorët e teksteve** do ta përdorin programin lëndor për të hartuar tekste që janë në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe klasë do t'i ndihmojë ata për të siguruar koherencën dhe për të shmangur ngarkesën e panevojshme.

**Specialistët e arsimit** mund ta përdorin programin lëndor për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj. Vlerësuesit e sistemit arsimor do të mbështeten në këtë program për të parë përmbushjen e standarteve lëndore të përcaktuara për këtë klasë.

**Fakultetet e mësuesisë** mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Përfituesit e programit janë: nxënësit, prindërit dhe komuniteti.

**Nxënësi** përfiton të nxënit progresiv, zbaton shprehitë njohuritë, veprmtaritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndën përkatëse dhe bëhet përdorues i mirë i gjuhës.

**Prindërit dhe komuniteti** mund të informohen për kompetencat që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës së huaj.

Programi lëndor “Gjuhë e huaj” ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të lëndës, nëpërmjet gjuhës së huaj do të realizohen temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe botën e punës. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor dhe t’i shërbejë formimit të tij të gjithanshëm.


Realizimi i programit në lëndën e gjuhës së huaj mundëson krijimin e një mjedisi të nxëni të përshtatshëm, inkurajues, motivues, gjithpërfshirës dhe të pasur me material të domosdoshme burimore duke përdorur sa më gjërë dhe në mënyrë efektive TIK.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës si edhe për çdo veprimtari, aftësi dhe shkathtësi gjuhësore që kryen nxënësi për formimin dhe konsolidimin e kompetencave.

Gjithashtu programi i jep mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe inovativ në punën e tij duke përdorur metodat, strategjitë dhe përfaqset më bashkëkohore në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit. Po kështu, në program janë sugjeruar edhe orët mësimore në përqindje për njohuritë që do merren gjatë vitit shkollor.

Diagrama e mëposhtme paraqet se si programi i gjuhës së huaj është pjesë integrale e Kornizës Kurikulare e cila synon një mësimdhënie me në qendër nxënësin, zhvillimin dhe përgatitjen e tij për t’u bërë anëtar i shoqërisë së dijes.

Diagrama 1: Korniza Konceptuale e Programit Lëndor “Gjuhë e huaj”



## Qëllimet e programit lëndor “Gjuhë e huaj”

Lënda e gjuhës së huaj në arsimin e mesëm të lartë ka si qëllim që nxënësi:

- )] të ndërgjegjësohet për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendit ku flitet gjuha e huaj dhe kulturës amtare duke analizuar aspekte të kulturës që studjon siç janë institucionet shoqërore dhe politike;
- )] të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme, për të hulumtuar dhe dhënë përgjigje e argumente për çështje të interesit të tij;
- )] të respektojë traditat dhe vlerat e kulturave të ndryshme;
- )] të forcojë ndërveprimin në situata reale dhe jashtëshkollore, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe të shkëmbejë informacione të detajuara mbi tema që paraqesin interes për të për të qënë i përgatitur për tregun e punës;
- )] të konsolidojë bashkëveprimin ndërmjet punës në grup dhe punës së pavarur individuale dhe krijuese edhe me folës të gjuhës të cilën ai mëson;
- )] të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave ai zgjeron njohuritë për botën dhe në të njëjtën kohë formohet intelektualisht;
- )] të zhvillojë rrjedhshmërinë në gjuhën e huaj përmes praktikës së vazhdueshme të përshtatshme për moshën, interesat dhe nivelin e tij gjuhësor.

Programi lëndor “Gjuhë e huaj” për klasën XI, i hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar (viti 2000), si dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER), synon të arrijë dhe të realizojë standartet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit me qëllim që t’i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimin të gjuhës së huaj në vendin tonë. Ky program përfshin njohuritë gjuhësore, ndërlëndore dhe ndërkulturore të përfituara ndër vite.



Lënda e gjuhës së huaj ka për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësit për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në këtë gjuhë. Ajo ka për detyrë të zhvillojë te nxënësi aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe t'a edukojë atë me të kuptuarin, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjerë. Programi hartohet mbi interesat dhe karakteristikat e grupmoshës dhe ndihmon në zhvillimin intelektual dhe socio-kulturor të nxënësit duke e bërë atë të pavarur dhe të aftë të përballojë të nxënit gjatë gjithë jetës. Nxënësi, gjithashtu, mëson dhe bindet se gjuha e huaj, si një subjekt aftësish dhe komunikimi, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t'u përvetësuar. Si lëndë akademike, gjuha e huaj është një lëndë kulturash dhe aftësish.

Niveli gjuhësor i gjuhës së huaj në klasën e XI në shkollat artistike dhe sportive, bazohet mbi njohuritë dhe konceptet e marra në klasat paraardhëse si dhe në konsolidimin e mëtejshëm të kompetencave kyçe dhe ato të lëndës për këtë shkallë. Nxënësi në këtë klasë forcon aftësinë e tij të të qenit i pavarur në përdorimin e gjuhës së huaj. Ai forcon njohuritë e B1+. Tiparet kryesore janë ato të B1 ( a. aftësia për të marrë pjesë në një bisedë b. të qenit fleksibël në përballjen me problemet që dalin në jetën e përditshme) por duke shtuar sasinë e informacionit dhe njohurive që merren.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit B1 i cili i referohet shkallës globale të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.

<p><b>Përdoruesi i pavarur</b></p>	<p><b>B 1</b></p>	<p>Mund të kuptojë çështjet kryesore të një informacioni standard të qartë për çështje të njohura që hasen rregullisht në shkollë, punë, argëtim etj. Mund t'ia dalë në situata të shfaqura gjatë një udhëtimi në vende ku flitet gjuha që mëson.</p> <p>Mund të prodhojë material të thjeshtë për tema të njohura ose të një fushe të interesit personal.</p> <p>Mund të përshkruajë përvoja dhe ngjarje, ëndrra, shpresa dhe ambicje dhe shkurtimisht jep arsye dhe spjegime për opinionet dhe planet.</p>
------------------------------------	-------------------	--

Interesat dhe tematikat në këtë program do të jenë të shumëllojshme (jeta personale e shoqërore, jeta në shkollë e në punë, bota rreth nesh, bota e komunikimit etj.), pasi shkalla e ndërgjegjësimit të nxënësit për domosdoshmërinë e mësimit të gjuhës së huaj është më e lartë dhe lidhet me problemet e formimit të tij si qytetar bote. Gjithashtu mësuesi në këto shkolla duhet të bëjë pjesë të mësimdhënies tema dhe situata të të nxëniet të cilat lidhen me profesionin për të cilin nxënësi është duke studiuar duke e aftësuar atë për karrierë të suksesshme në tregun e punës.

### **Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”**

Realizimi i kompetencave kyçe të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës dhe të lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxëniet. *Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.* Kur nxënësi përmbush kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e gjuhës së huaj, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxëniet të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Gjithashtu e parë në kontekstin e anasjelltë nxënësi ndihmohet nga kompetencat kyçe për të përmbushur sa më mirë kompetencat specifike të lëndës dhe për të realizuar veprimtaritë gjuhësore. Si p.sh kur nxënësi lexon një tekst ai nuk bazohet vetëm tek kompetenca gjuhësore por edhe tek kompetenca e të menduarit ose ajo qytetare bazuar në llojin e tekstit që lexon, ose nëse nxënësi lexon një tekst si pjesë e një programi të të mësuarit ai bazohet te kompetenca e të mësuarit për të nxënë.

Një tjetër shembull do të ishte edhe zhvillimi i një projekti gjatë orës mësimore. Nëse nxënësi bën një projekt si temë mësimore në këtë rast ai jo vetëm zhvillon kompetencat e tij gjuhësore, por gjithashtu kompetencat digjitale dhe qytetare, në varësi të tematikës që ai shtjellon.

Përjasja e adoptuar nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (KPER) është e orientuar drejt veprimit pasi përdoruesi i gjuhës ose nxënësi konsiderohet si “aktor shoqëror” d.m.th. pjesëtar i shoqërisë i cili ka detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrethana dhe në një mjedis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi. Komunikimi realizohet nëpërmjet aktiviteteve gjuhësore të cilat janë pjesë e një konteksti më të gjerë shoqëror që ju jep atyre kuptim të plotë. Përjasja vepruese merr gjithashtu parasysh burimet njohëse, emocionale, të vullnetshme si edhe tërësinë e aftësive që zotëron dhe vë në jetë çdo individ si një aktor shoqëror.

Në bazë të kësaj përjasjeje çdo formë përdorimi dhe nxënieje e një gjuhe mund të përkufizohet si më poshtë.

Përdorimi i një gjuhe, duke përfshirë edhe nxënien e saj, përfshin veprime të kryera nga njerëzit, të cilët si individë dhe si aktorë shoqërorë zhvillojnë një numër kompetencash kyçe dhe në veçanti kompetencën e komunikimit gjuhësor. Nxënësi vë në zbatim kompetencat që zotëron në kontekste dhe kushte të ndryshme dhe kalon vështirësitë për t'u përfshirë në veprimtari gjuhësore të cilat përfshijnë proceset gjuhësore që mundësojnë kuptimin dhe prodhimin e teksteve që lidhen me tema dhe fusha specifike duke mobilizuar strategjitë më të përshtatshme për përmbushjen e detyrave që duhen realizuar. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë nxënësi çon në përforsimin ose përmirësimin e kompetencave. Kjo përjasje ilustron në figurën e mëposhtme.



**Figura 1:** Të mësuarit dhe përdorimi i gjuhës së huaj

Kompetencat kyçe nuk lidhen vetëm me gjuhën por kanë të bëjnë me çdo lloj veprimtarie duke përfshirë edhe ato gjuhësoret.


Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

- )] përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- )] përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat specifike të lëndës që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- )] përshtat rezultatin/et e të nxënit për çdo fushë veprimtarie dhe mënyre të marrjes së gjuhës (me shkrim dhe me gojë): **marrja e informacionit** (të lexuarit,të dëgjuarit), **ndërveprimi** (të folurit ndërveprues,të shkruarit ndërveprues), **produkti** (produkti i të folurit,produkti i të shkruarit) dhe **ndërhyrja** (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi etj);
- )] përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- )] planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;

) kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënësve për vit mësimor dhe shkallë për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

Diagrama e mëposhtme konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës të cilat së bashku i ofrojnë nxënësit informacionin në mënyrë efektive dhe bëjnë që nxënësi të përforcojë hap pas hapi arritjet e tij për të lexuar, shkruar dhe komunikuar duke i bërë funksionale dhe të qëndrueshme aspekte të ndryshme të informacionit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë.

**Diagrama**  
kyçe me  
“Gjuhë e



**2:Lidhja e kompetencave**  
kompetencat e lëndës  
huaj”

## Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës “Gjuhë e huaj”

### Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

#### Nxënësi:

- ) diskuton në grup në mënyrë konstruktive në jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat mësimore ose nga jeta e përditshme;

- ) transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit;
- ) lexon rrjedhshëm një tekst të njohur në gjuhë të huaj të përbërë prej disa paragrafësh;
- ) tregon me shembuj konkretë disa nga ngjashmëritë ndërmjet strukturës së fjalisë së gjuhës së huaj dhe gjuhës amtare;
- ) analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun e përshtatshëm;
- ) shkruan një tekst në gjuhë të huaj për një temë nga jeta e përditshme, me tre-pesë paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të saktë;
- ) përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës së huaj në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letra formale dhe joformale etj;
- ) përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj;
- ) përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore;
- ) prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke gërshtuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik.

### **Kompetenca e të menduarit**

#### **Nxënësi:**

- ) përzgjedh dhe klasifikon informacionin nga burime të ndryshme në bazë të një kriteri të caktuar për një temë konkrete dhe e përdor për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre;
- ) prezanton në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacionit për një temë të

caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.);

- )] krahason të paktën tri burime të ndryshme informacioni për trajtimin e një teme, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë e informacionit;
- )] përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar qëllimin, aktivitetet kryesore, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre;
- )] modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për një temë të caktuar, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit;
- )] argumenton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët çojnë në përfundimin e një detyre/veprimtarie, në zgjidhjen e një problemi, të ndonjë punimi në klasë/shkollë;
- )] simulon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar, duke u bazuar në këtë përvojë, merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë.

### **Kompetenca e të nxënit**

#### **Nxënësi:**

- )] demonstroi shkathtësi në lexim, shkrim dhe komunikim për përmbushjen e kërkesave të ndryshme në kryerjen e një detyre ose aktiviteti;



- ) regjistron në formë të shkruar, grafike, etj., informacionin/faktet për një temë;
- ) shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në gjuhë të huaj;
- ) shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje /projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj;
- ) diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- ) paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.);
- ) shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke klasifikuar informacionin e njohur nga ai i panjohur, si dhe atë që është i paqartë;
- ) parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar;
- ) përdor elementet e portofolit personal për vetëvlerësimin dhe identifikimin e anëve të forta, i shfrytëzon ato për përparimin në mësimet dhe për orientimin për karrierë;
- ) shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë e informacionit dhe burimet e tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.

### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

**Nxënësi:**

- )] përgatit një autobiografi ku prezanton veten me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke vënë theksin te aftësitë, dëshirat, dhe mundësitë, referuar qëllimeve apo projektit individual për karrierën;
- )] demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në grup përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore ose në veprimtari për jetën, për punën dhe për mjedisin, duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit;
- )] hartoi një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe duke vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe informative, në përputhje me rezultatet e pritshme;
- )] merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle dhe më gjerë (p.sh., konkurse, gara sportive, aktivitete kulturore dhe muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura dhe për procesin e organizimit, si dhe jep argumente të ndryshme shprehëse se si të rritet pjesëmarrja në aktivitete dhe se si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre;
- )] përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim;
- )] identifikon burime të ndryshme informacioni për arsimim dhe orientim profesional, si dhe zhvillon një plan individual për zhvillimin e karrierës së tij;
- )] diskuton me një fjalor të thjeshtë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar, duke prezantuar idetë nëpërmjet shembujve konkretë.

### **Kompetenca personale**

#### **Nxënësi:**

- )] analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë zhvillimin personal, në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale;
- )] merr pjesë aktivisht në lojëra, debate apo në veprimtari të tjera në klasë dhe në mënyrë konstruktive menaxhon emocionet e veta;

- )] bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët. (projekti/ aktiviteti në bazë klase /shkolle apo jashtë saj);
- )] ilustron me shembuj para të tjerëve, modelet dhe praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë;
- )] analizon veprimet e veta dhe të kolegëve gjatë një situatë konflikti, duke propozuar alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit;
- )] gjykon mënyrën e komunikimit, të sjelljeve dhe të qëndrimeve që nxisin konflikte ndërpersonale në klasë, në shkollë apo në shoqëri, duke vënë theksin në faktorët që kanë ndikuar në shfaqjen e saj dhe jep shembuj të menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve ndërpersonale në mënyrë konstruktive.

### **Kompetenca qytetare**

Nxënësi:

- )] shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët, për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;
- )] demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët;
- )] përgatit në grup një aktivitet dhe drejton formë të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike dhe tregon tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- )] praktikon të drejtat dhe detyrimet si qytetar në situata konkrete të jetës së përditshme, në klasë, shkollë, komunitet ose gjatë diskutimit dhe respektimit të mendimit të tjetrit;
- )] reagon ndaj personave të cilët shkelin, cenojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve si dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për

individin, grupin dhe komunitetin;

- ) diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., si dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë, në një fushë të caktuar;
- ) demonstroi me sjelljen e tij, me detyra, projekte dhe prezantime shembuj të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe propozon alternativa se si të gjithë qytetarët mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme për këtë proces;
- ) përshkruan dhe shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të grupit, dallon rastet kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjes së tyre.

### **Kompetenca digjitale**

#### **Nxënësi:**

- ) përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënit dhe për të rritur efektivitetin në mësimdhënie;
- ) përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- ) bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pjesëve të filmuara apo të animuara, për të trajtuar tema mësimore, për të zgjidhur çështje dhe probleme që mund të lindin në shkollë dhe jashtë saj;
- ) zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediet digjitale;
- ) diskuton për avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të teknologjive në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit.

## Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënës, të cilat ndihmojnë nxënësin të interpretojë botën dhe të lidhë dijet e marra në shkollë me jetën dhe interesat e tij. Në Kornizën Kurrikulare dhe në Kurrikulën Bërthamë të AML janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:

- ) Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- ) Të drejtat e njeriut.
- ) Vendimmarrja morale.
- ) Zhvillimi i qëndrueshëm.
- ) Mjedisi.
- ) Ndërvarësia.
- ) Bashkëjetesa paqësore.

Gjuha e huaj zhvillon te nxënësi njohjen e vlerësimin e kulturës dhe traditës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj. mund të realizohen gjatë orëve mësimore ku mësuesi mund të krijojë situata të të nxënës gjatë të cilave nxënësi shpreh në forma të ndryshme ( ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çështjet e mësipërme) mendimet e tij të pavarura dhe të mbështetura me argumenta dhe shembuj nga jeta e përditshme.

Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësit për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët, me natyrën dhe për të promovuar detyrat dhe të drejtat e individit në një shoqëri të lirë dhe demokratike si dhe për të promovuar historinë e kulturën e kombit të tij dhe të vendit gjuhën e të cilit mëson.

## Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare

Programi lëndor “Gjuhë e huaj” mbështetet në integrimin ndërlëndor. Gjuha e huaj e pajis nxënësin me njohuri, aftësi dhe shkathtësitë që sigurojnë suksesin e tij edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Kompetencat gjuhësore janë kompetenca që ndihmojnë nxënësin në procesin e të nxënies në të gjitha fushat kurrikulare. Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore dhe ligjërimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës së huaj dhe të trajtuara në lëndët e tjera.

Nxënësi zgjeron fjalorin dhe zhvillon aftësinë e të shprehurit qartë me shkrim dhe me gojë në fushat e tjera.


Gjuha e huaj mundëson nxënësin që të kuptojë dhe analizojë tekste ose mesazhe të ndryshme. Duke lexuar tekste të fushave të ndryshme (gjeografi, qytetari etj) nxënësi zgjeron njohuritë për atë fushë. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon në të kuptuarin e ngjarjeve dhe figurave historike si dhe të vlerave shoqërore. Me fushën shoqëria dhe mjedisi janë të lidhura tema si: miqësia, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, koha e lirë, festat etj.

Duke përvetësuar aktet dhe funksionet gjuhësore nxënësi mëson si të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte dhe gramatikisht të saktë.

Gjithashtu përvetësimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon nxënësin të zhvillojë më tej punën e tij kërkimore në fushat e tij të interesit (histori,shkenca, matematikë etj) pasi shumë materiale gjenden në gjuhë të huaj. Integrimi i lëndëve të tjera në gjuhën e huaj ndihmon jo vetëm në lidhjen ndërlëndore por edhe në pasurimin e një leksiku më specifik dhe përdorimin e tij. Lidhja me *shkencat natyrore* p.sh. matematikës dhe gjuhës së huaj shprehet në mësimin numrave, veprimeve matematikore (mbledhja e zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi).

Në lëndën e biologjisë, lidhja bëhet e qartë duke trajtuar tema, si: pjesët e trupit, ushqyerja, shëndeti, mjedisi.Me artet janë të lidhura ngushtë temat mbi sportin, muzikën, modën, pikturën etj.Lidhja me lëndën e TIK-ut, përmes së cilës nxënësi aftësohet të përdorë internetin, e-mail-in, programe të ndryshme, platforma digjitale, aplikacione etj, ndihmon atë të eksplorojë të rejtat mbi botën që po studion, të prezantojë sa më

bukur dhe në mënyrë logjike idetë dhe opinionet e tij dhe të marrë informacion në kohë reale. Më konkretisht, kjo lidhje jepet në diagramën e mëposhtme.



**Diagrama 3:**  
*“Gjuhë e huaj”*  
kurrikulare

*Lidhja e lëndës me fushat e tjera*

## Kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”

**Kompetencat e komunikimit gjuhësor** janë ato të cilat e fuqizojnë një person të veprojë duke përdorur specifikisht mjetet dhe mënyrat gjuhësore.



Për të realizuar qëllimet komunikuese, nxënësi mobilizon të gjitha kapacitetet e tij dhe i kombinon ato me kompetencën e komunikimit gjuhësor. Kompetenca e komunikimit gjuhësor është një sintezë e njohurive të parimeve bazë gramatikore, e njohurive se si gjuha përdoret në ambiente shoqërore për të kryer funksionin komunikues dhe e njohurive se si funksionet komunikuese kombinohen me parimet e ligjërimit.

### **Përshkrimi i kompetencave të lëndës**

Kompetenca e komunikimit gjuhësor përbëhet nga kompetencat e mëposhtme:

**Kompetenca gjuhësore** nënkupton përvetësimin e rregullave gramatikore, semantike, fonetike, ortografike si dhe pasurimin e fjalorit.

**Kompetenca socio-gjuhësore** ka të bëjë me dimensionin shoqëror të gjuhës dhe i referohet të mësuarit të akteve të ndryshme të ligjërimit dhe komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore. Këto kontekste kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit si dhe me faktorë të tjerë që influencojnë në stilin dhe rregjistrat e gjuhës. Zhvillimi i kësaj kompetence është shumë i rëndësishëm pasi në situata të ndryshme duhen përdorur lloje të ndryshme shprehjesh si edhe duhen mbajtur qëndrime, besime, vlera dhe pikëpamje të ndryshme.

**Kompetenca pragmatike** ka të bëjë me njohjen e rregullave dhe parimeve sipas të cilave mesazhi komunikues organizohet dhe strukturohet (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve) dhe realizimin e funksioneve komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rrënia dakort, përshendetjet etj).


Dy faktorë cilësorë të cilët përcaktojnë suksesin e nxënësit në realizimin e funksioneve komunikuese janë:

- a. Rrjedhshmëria
- b. Saktësia e të shprehurit

Duke u bazuar tek kompetencat kyçe dhe ato të komunikimit gjuhësor, nxënësi përdor aftësi dhe strategji të përshtatshme për përmbushjen e detyrave në veprimtaritë gjuhësore (me shkrim dhe me gojë): marrja e informacionit (të lexuarit, të dëgjuarit), ndërveprimi (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), produkti (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe ndërhyrja (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi etj). Kryerja e vazhdueshme e veprimtarive gjuhësore bën që nxënësi të forcojë aftësitë dhe shkathtësitë e **të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.**

Lidhja midis aftësive, shkathtësive, veprimtarive dhe kompetencave mund të shihet si një lidhje burimore ku nxënësi gjen tek kompetencat mjetet për të realizuar veprimtaritë, por këto të fundit modifikohen dhe shtohen gjatë procesit të komunikimit. Një numër i kufizuar kompetencash i lejon nxënësit të kryejë një numër shumë të madh veprimtarish. Të kuptuarit e këtij dallimi është thelbësor për të bërë të suksesshëm procesin e të mësuarit dhe të nxënimit të gjuhëve.

Përdorimi i gjuhës veçanërisht në ndërveprim me të tjerët lejon përvetësimin e gjuhës, e cila në vetvetë përfshin zhvillimin e kompetencave. Të mësuarit e pakontekstualizuar të kompetencave (si p.sh mësimi i rregullave gramatikore) e ndihmon nxënësin, por nuk është i mjaftueshëm për të përdorur gjuhën si një mjet komunikimi.



*Diagrama 4: Lidhja e kompetencave të lëndës “Gjuhë e huaj” me veprimtaritë, aftësitë dhe shkathtësitë gjuhësore*

### Rezultatet e të nxënit

KOMPETENCA	REZULTATET
------------	------------

<p><b>GJUHËSORE</b></p> <p>Nxënësi e zotëron gjuhën në atë mënyrë që mund të përshkruajë situat të paparashikuara, të shpjegojë pikat kryesore të një ideje ose problemi me saktësi dhe të shprehë mendimet mbi tema abstrakte dhe kulturore si muzika, filmat etj.</p>	<p><b>Fjalori</b></p>	<p>Nxënësi zotëron fjalor të mjaftueshëm për të përshkruar situata të njohura dhe të paparashikuara, shpjegon me saktësi por ndonjëherë edhe me hezitim pikat kryesore të një problemi duke përdorur edhe fjali të përbëra. Nxënësi ka fjalor të mjaftueshëm për t'u shprehur rreth fushave të tij të interesit si familja, interesat, dëshirat, udhëtimet, puna dhe ngjarjet aktuale. Nxënësi demonstroi me saktësi leksikore relativisht të lartë por akoma bën gabime kur shpreh mendime mbi situatë të vështira dhe të panjohura për të.</p>
	<p><b>Saktësia gramatikore</b></p>	<p>Nxënësi tregon relativisht një shkallë të lartë kontrolli dhe komunikoni me saktësi gramatikore në kontekste të njohura si edhe nuk bën gabime që të çojnë në keqkuptime të asaj që do të shprehë. Ndonjëherë nxënësi mund të ndikohet nga gjuha amëtare.</p>
	<p><b>Fonetika</b></p>	<p>Nxënësi është i qartë në të folur dhe në shqiptimin e fjalëve megjithëse ka raste të pakta kur shqiptimi nuk është i saktë.</p>
	<p><b>Ortografia</b></p>	<p>Nxënësi krijon tekste të gjata dhe shkruan pothuajse pa gabime dhe është i saktë në përdorimin e shenjave të pikësimit pavarësisht se ndonjëherë mund të tregojë ndikime të gjuhës amëtare.</p>
<p><b>SOCIO-GJUHËSORE</b></p>	<p><b>Aktet e ligjërimit dhe komunikimit</b></p>	<p>Nxënësi kryen dhe ju përgjigjet një game të gjerë funksionesh gjuhësore duke përdorur shprehjet e zakonshme të një rregjistri neutral. Nxënësi njeh rregullat e mirësjelljes dhe vepron në mënyrë të përshtatshme me to. Nxënësi shprehet qartë në situatë të ndryshme dhe shmang gabimet në formulimin e ideve. Nxënësi njeh</p>

		mirë ndryshimet midis kulturave, qëndrimeve, vlerave dhe besimeve që mbizotërojnë në vendin e tij dhe në vendet ku flitet gjuha e huaj.
<b>PRAGMATIKE</b>	<b>Fleksibiliteti</b>	Nxënësi përshtat shprehjet e mësuara për t'i përdorur në situata më pak të njohura dhe të vështira për të.
	<b>Pjesëmarrja në bashkëbisedim</b>	Nxënësi ndërhyt dhe merr fjalën në një bisedë me temë të njohur për të duke përdorur shprehjet e mësuara.
	<b>Zhvillimi i temës</b>	Nxënësi tregon në mënyrë logjike dhe të rrjedhshme një tregim ose përshkrim në mënyrë lineare por ka raste që përdor argumenta dhe shembuj të tjerë.
	<b>Koherenca</b>	Nxënësi lidh pjesë të shkurtra dhe të thjeshta në një tekst të plotë në mënyrë lineare duke tentuar për tekste më të komplikuar.

#### Aspektet cilësore të përdorimit të gjuhës së folur për nivelin B 1

	<b>Gama/diapazoni</b>	<b>Saktësia</b>	<b>Rrjedhshmëria</b>	<b>Ndërveprimi</b>	<b>Koherenca/ lidhja logjike</b>
<b>B 1</b>	Zotëron mjaftueshëm fjalor për të shprehur veten duke hezituar dhe duke perifrazuar mbi tema si familja,	Përdor pothuajse saktë një repertor shprehjesh të rutinës së përditshme që përdoren dendur dhe lidhen me situata të	Mund të flasë në mënyrë të kuptueshme, megjithëse duket qartë që ndalon për ta menduar atë që do të	Mund të fillojë, vazhdojë dhe përfundojë biseda ballë për ballë mbi tema që janë të njohura për të ose të interesit të tij. Përsërit	Mund të lidhë në mënyrë lineare një numër të vogël dhe të thjeshtë elementësh të

interesat, puna, shkolla, udhëtimet dhe ngjarjet nga jeta e përditshme.	parashikueshme.	thotë mirë nga ana gramatikore dhe leksikore si dhe bën korrigjime sidomos kur flet gjatë.	pjesë të asaj që është thënë për të konfirmuar të kuptuarin reciprok.	të folurit.
---	-----------------	--	---	-------------

Për përmbushjen e kompetencave të lëndës të cilat çojnë natyrshëm në forcimin e kompetencave kyçe, nxënësit i duhet të konsolidojë njohuritë dhe konceptet e duhura, të aftësohet në shkathtësitë e fituara dhe të mbajë qëndrime dhe të zhvillojë vlera në situata të ndryshme.

### Njohuri dhe koncepte:

#### 1. Formimi kulturor:

- a. **Jeta e përditshme** (*organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; kujtime të mrekullueshme- dita më e bukur e jetës sime; qëllimet afatshkurtër dhe afatgjatë. Çfarë dua unë për të ardhmen time etj*)
- b. **Bota e shkollës dhe e punës** (*Organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme si papunësia etj; Studimet dhe universitetet në vend dhe në botë, profesionet* )
- c. **Jeta personale dhe shoqërore** (*Shanse dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, të rinjtë dhe të rriturit; vendlindja; personalitete në shoqëri*)
- d. **Bota rreth nesh** (*Arti dhe kultura; flora dhe fauna; arkeologjia; historia e filmit/sportit;programet televizive; zakonet dhe traditat në vendet ku flitet gjuha që po mësohet etj.*)
- e. **Bota e komunikimit** (*rrjetet sociale; interneti; të shkruarit e letrave- letër kërkesë,letër ankesë, letër biznesi, etj*)

#### 2. Formimi gjuhësor:

- a. **Gramatika** ( ndajfoljet ; mbiemrat dhe strukturat e tyre; fjalitë e thjeshta dhe të përbëra.; kohët e foljeve; ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë; mënyra veprorë dhe jo veprorë; foljet modale; fjalitë kushtore etj)
- b. **Funksionet gjuhësore** (dhënia e këshillave; të shprehurit e keqardhjes; theksimi i informacionit; të shprehurit e mendimin ose opinionit personal; vënia në diskutim ose të mos biesh dakort me dikë; të ndalosh dikë të bëjë dicka etj.)

**Aftësi dhe shkathtësi:**

**Të dëgjuarit**

**Përshkrimi :**

Nxënësi kupton informacion faktik të drejtpërdrejtë rreth temave të zakonshme të jetës së përditshme dhe botës së punës duke identifikuar si idenë kryesore edhe detajet specifike kur e folura është e artikuluar qartë dhe me aksent të njohur për të. Gjithashtu nxënësi arrin të ndjekë biseda më të zgjeruara argumentuese kur flitet në gjuhë standarte.

**Nxënësi:**

- )] ndjek një bisedë të zakonshme megjithëse ndonjëherë ka nevojë për përsëritjen e fjalëve dhe frazave të veçanta;
- )] ndjek pikat kryesore të një bisede të zgjeruar që zhvillohet rreth tij nëse biseda e dhënë shqiptohet qartë në gjuhë standarte;
- )] kupton një tregim të shkurtër;
- )] kupton çështjet kryesore si edhe përmbajtjen e informacionit të lajmeve në radio dhe materialet e regjistruara mbi tema të interesit personal të shprehura ngadalë dhe qartë;
- )] kupton çështjet kryesore në programet televizive mbi tema të njohura;
- )] kupton informacionin e thjeshtë teknik si instruksione të përdorimit për pajisjet e përdorimit të përditshëm;
- )] kupton idetë kryesore të një bisede në një dialekt standart;
- )] Ndjek një leksion ose bisedë mbi fushën e tij të interesit kur tema është e njohur për të dhe prezantimi është i mirëstrukturuar dhe i

drejtpërdrejtë.

### **Të lexuarit**

#### **Përshkrimi:**

Nxënësi lexon tekste faktikë të drejtpërdrejtë me tema që lidhen me fushën e tij të interesit në një shkallë të kënaqshme të kuptuari të teksteve. Nxënësi ka fjalor të gjerë por mund të ketë vështirësi me shprehjet që hasen rrallë në të lexuar.

#### **Nxënësi:**

- )] kupton çështjet kryesore në artikuj të shkurtër gazetash rreth temave të përditshme;
- )] lexon dhe të kupton artikuj apo intervista në gazeta dhe revista në të cilat mbahet qëndrim për një temë të veçantë;
- )] gjen kuptimin e fjalëve ose shprehjeve të panjohura nga konteksti nëse tema është e njohur;
- )] kap thelbin në tekste të shkurtra për shembull, përmbledhje lajmesh dhe gjen fakte dhe informacione në lidhje me vendin, kohën dhe personazhet;
- )] kupton informacionin më të rëndësishëm në fletpalosje të thjeshta;
- )] kupton udhëzimet e dhëna me shkrim për përdorimin e pajisjeve të ndryshme;
- )] kupton përshkrimin e ngjarjeve, ndjenjave dhe dëshirave në letra personale aq mirë sa për të mbajtur korrespondencë me shokët e tij;
- )] kupton mesazhe të shkurtra dhe letra formale të tilla si letra zyrtare dhe biznesi;
- )] kupton ato pjesë në letrat private që lidhen me ngjarje, ndjenja, urime dhe dëshira;

- )] kupton subjektin e një tregimi të ndërtuar mirë duke u njohur me episode dhe ngjarjet më të rëndësishme dhe rolin që ato luajnë në histori;
- )] kupton me vështirësi dhe lexon artikuj në të cilat autori shpreh pikpamje të caktuara personale;
- )] kupton përmbledhje që kanë të bëjnë me tema kulturore si filma, libra etj;
- )] shqyrton tekste të gjatë për të gjetur informacionin e dëshiruar dhe mbledh informacion nga pjesë të ndryshme të tekstit ose tekste të ndryshëm për të kryer një detyrë të caktuar;

### **Të folurit**

#### **Të folurit ndërveprues:**

##### **Përshkrimi:**

Nxënësi komunikon me besim mbi temat e fushës së tij të interesit duke shkëmbyer, kontrolluar ose konfirmuar informacionin dhe shpjegon se pse diçka është problem. Nxënësi shpreh mendimin e tij mbi tema abstrakte dhe kulturore si filmat, librat, muzika.

##### **Nxënësi:**

- )] kërkon dhe kupton udhëzime të detajuara për të shkruar nga një vend në tjetrin edhe në situata të panjohura për të;
- )] përballon në të shumtën e rasteve situata që dalin gjatë një udhëtimi ose një konsulte mjekësore;
- )] shpreh dhe kërkon mendimin personal gjatë një diskutimi me shokë;
- )] diskuton dhe mbron mendimin e tij në biseda të përgjithshme mbi tema të specialitetit të tij;
- )] shprehet me mirësjellje nëse është dakort ose jo rreth një teme të caktuar;
- )] shpreh dhe ju përgjigjet ndjenjave të tilla si : lumturia, trishtimi, interesi dhe indiferenca;



- J mban gjallë një bisedë apo diskutim , por nganjëherë e ka të vështirë të shprehet saktësisht për çfarë do të dëshironte;
- J hyn edhe i papërgatitur në një bisedë ose intervistë;
- J përçon gjatë bisedës shkallë të ndryshme emocioni si edhe vë në dukje rëndësinë që ato kanë për të personalisht;
- J komenton shkurt mbi pikpamjet e të tjerëve;
- J sqaron qartë pikpamjen e tij por ka vështirësi të bëhet pjesë e një debati;
- J krahason alternativa të ndryshme dhe shpjegon pse diçka është problem;
- J ankohet kur ka blerë një produkt që nuk është sipas dëshirës së tij;
- J përmbledh një histori të shkurtër, intervistë duke dhënë mendimin e tij dhe ju përgjigjet pyetjeve për detajet e mëtejshme;
- J jep informacion konkret që mund t'i kërkohej gjatë një interviste, konsulte etj.

#### **Produkti i të folurit:**

##### **Përshkrimi:**

Nxënësi në mënyrë te logjikshme bën përshkrim të një game të gjërë temash brenda fushës së tij të interes duke e paraqitur atë në vijë lineare. Gjithashtu nxënësi tenton të bëjë përshkrime të qarta dhe të detajuara për një gamë të gjerë temash që lidhen me fushat e tij të interes duke i zgjeruar idete dhe mbështetur ato me shembuj.

##### **Nxënësi:**

- J përshkruan në detaje përvoja , ndjenjat dhe reagimet që lidhen me to;
- J përshkruan ëndërra , shpresa, ambicie, urime dhe dëshira;
- J përshkruan ngjarje reale ose imagjinare;
- J shpjegon dhe jep arsye për planet, synimet dhe veprimet e tija;

- ) lidh ngjarjet në një subjekt libri ose filmi dhe përshkruan reagimet e tija;
- ) perifrazon gojarisht pasazhe të shkruara shkurt, duke përdorur fjalorin dhe strukturën e një teksti original;
- ) rrëfen një histori;
- ) rrëfen detaje të një ngjarjeje të paparashikuar, p.sh një aksident;
- ) zhvillon një argument aq mirë sa mund të ndiqet pa vështirësi në pjesën më të madhe të kohës;
- ) mban një fjalim të shkurtër të parapërgatitur mbi tema të jetës së përditshme ose të interesit të tij;
- ) prezanton mbi një temë të njohur prej tij ku shumica e çështjeve shpjegohen me saktësi;

### **Të shkruarit**

#### **Përshkrimi:**

Nxënisi shkruan tekste të plota mbi tema të fushës së tij të interes duke i lidhur pjesët përbërese të tij në mënyrë lineare. Gjithashtu nxënësi me vështirësi arrin të vlerësojë informacionin e marrë nga burime të ndryshme dhe të japë argumentat mbështetës. Nxënësi transmeton informacionin dhe idetë mbi tema konkrete dhe abstrakte, pyet dhe jep shpjegime mbi problemet me saktësi logjike.

#### **Nxënësi:**

- ) shkruan tekste të thjeshta të lidhura në mënyrë lineare për tema të interesit të tij duke shprehur pikpamjet dhe opinionet e tija;
- ) shkruan tekste të thjeshta rreth përvojave (një udhëtim, një shfaqje në shkollë, një konkurs) për gazetën e shkollës ose të klubit;

- ) përshkruan një ngjarje reale ose imagjinare;
- ) fillon të shkruajë përshtypjet e tij mbi një libër, film ose shfaqje;
- ) shkruan letra personale familjes ose shokëve të tij për t'i pyetur , për t'u dhënë lajme të reja ose për t'u treguar një ngjarje;
- ) përshkruan me detaje në një letër personale përmbajtjen e një libri , filmi ose komenton për një koncert ose shfaqje;
- ) shpreh ndjenja si p.sh lumturinë , hidhërimin, interesin, keqardhjen, në një letër;
- ) përgjigjet me shkrim një lajmërimi dhe pyet për informacion më të plotë ose më specific rreth mallrave ose shërbimeve. (p.sh një telefon celular , kompjuter ose një kurs mësimor);
- ) transmeton nëpërmjet faksit ose e-mailit informacion të shkurtër dhe të thjeshtë tek shokët ose të njohurit e tij si dhe u kërkon atyre informacion;
- ) shkruan CV-në i tij në formë të përmbledhur;
- ) shkruan saktë dhe shkurt një përmbledhje të artikujve mbi tema të përgjithshme;
- ) shkruan një përmbledhje të pikave kryesore në informacione nga media dhe burime të tjera;
- ) shkruan ese të thjeshta mbi temat e tij të interesit;
- ) shkruan mesazhe që transmetojnë pyetje dhe shpjegime të problemeve.

### **Vlera dhe qëndrime:**

#### **Nxënësi:**

- ) demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;
- ) demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- ) respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- ) tregon gatishmëri për të bashkëpunuar;

- J ndjek më vëmendje shokët kur flasin dhe respekton rradhën e të folurit;
- J përzgjedh fjalorin e duhur (nuk fyen, përdor fjalët e mirësjelljes etj);
- J tregon interes në materialet që lexon;
- J respekton bashkëfolësit pa dallime gjinie, besimi, ideje;
- J respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- J demonstroi bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe në diskutime;
- J demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- J vlerëson burime të ndryshme informacioni;
- J mban qëndrimin e tij ndaj problemeve që dalin në klasë dhe në shkollë;
- J është i paanshëm në marrjen e vendimeve.

Për të kryer detyrat që i jepen nxënësi duhet të përfshihet në veprimtari të shumta gjuhësore dhe të përdorë strategji komunikuese. Strategjitë konsiderohen si një lidhëse midis burimeve të nxënësit (kompetencat) dhe se çfarë ai mund të bëjë me ato (veprimtaritë komunikuese). Shumica e situatave përfshijnë llojshmëri veprimtarish dhe përdorim të më shumë se një aftësie ose shkathtësie. Për shembull në një orë mësimi, një nxënësi i kërkohet të dëgjojë shpjegimin e mësuesit, të lexojë një tekst me zë ose në heshtje, të ndërveprojë me nxënësit e tjerë në grup, të shkruajë një ushtrim ose ese madje edhe të perifranojë, shpjegojë etj. Strategjitë janë mjeti që nxënësi përdor për të mobilizuar dhe balancuar të gjitha burimet e tij, të aktivizojë të gjitha aftësitë e tij për të përmbushur plotësisht dhe me sukses detyrat që i jepen.

**Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtari prodhuese ( produkti i të folurit/ produkti i të shkruarit)**

Planifikimi

Përsërit dhe provon kombinime dhe shprehje të reja duke kërkuar përshtypjet e të tjerëve.

Kompensimi	Jep dhe shpjegon tiparet e diçkaje konkrete kur nuk e di fjalën e saktë.
Monitorimi dhe korigjimi	Korigjon gabimet në kohët e foljeve dhe shprehjeve të cilat mund të çojnë në keqkuptime nëse bashkëfolësi thotë se nuk kupton mesazhin e dhënë.
<b>Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë marrëse (të kuptuarit gjatë të dëgjuarit dhe të lexuarit)</b>	
Identifikimi i të dhënave ndihmëse dhe gjetja e kuptimit	Gjen kuptimin e fjalëve të reja nga konteksti mbi tema që kanë të bëjnë me fushën e tij të interesit dhe nxjerr kuptimin e të gjithë fjalisë nëse tema është e njohur për të.
<b>Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë ndërvepruese (të folurit ndërveprues/ të shkruarit ndërveprues)</b>	
Marrja e fjalës në bashkëbisedim	Ndërhyn në një diskutim me temë të njohur për të dhe përdor shprehjet e duhura për të marrë fjalën.
Bashkëpunimi	Shfrytëzon një repertor bazë të gjuhës dhe të strategjive për të mbajtur gjallë një bisedë ose diskutim.
Pyetje për t'u qartësuar	Pyet bashkëfolësin të qartësojë osë të shtjellojë atë çka është duke thënë.

## Ndarja e orëve mësimore

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasën e XI, sipas orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit të Mesëm të orientuar-shkollat artistike dhe sportive.

**Orët Mësimore** 36 javë x 2 orë/javë = 72 orë vjetore

Klasa XI	Formimi kulturor	Formimi gjuhësor		Puna me portofolin	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		
	40%	30%	20%	10%	72 orë
	29 orë	22 orë	14 orë	7 orë	

Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të përcaktuara në tabelë duke pasur parasysh karakteristikat e çdo klase si edhe përparimin e nxënësve.

Tek orët e formimit kulturor përfshihen pjesët e reja të leximit dhe të dëgjimit të cilat përfshijnë njohuritë që merr nxënësi mbi botën e punës, shkollës, jetës personale, natyrës, udhëtimet, kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme etj. Nëse mësuesi vë re se disa njohuri nuk mund të përvetësohen nga nxënësi brenda një ore mësimore, ai planifikon orë rimarrje për ato njohuri.

Orët e formimit gjuhësor mbi gramatikën përfshijnë njohuritë gramatikore dhe punën me fjalorin që realizohet gjatë vitit. Këtu mund të përfshihen edhe orët e përforsimit të njohurive nëse mësuesi e shikon të nevojshme. Gjithashtu njohuritë gramatikore nuk mund të merren jashtë

kontekstit dhe duke patur parasysh që përfaqësja në kurrikulën bërthamë është të mësuarit nëpërmjet situatave të të nxënësve, këto njohuri mund të ndërthuren edhe gjatë orëve kur fokusi është të folurit ose të shkruarit.

Funksionet gjuhësore ju referohen akteve të komunikimit që nxënësi realizon gjatë procesit të marrjes së gjuhës së huaj dhe mund të realizohen në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e tjera.

Vlerësimi i nxënësit bëhet i mbështetur edhe në punët e tij të portofolit. Si rezultat del domosdoshmëri që mësuesi të planifikojë orë edhe për realizimin e projekteve dhe punëve të portofolit.

Teste të detyruara gjatë një viti shkollor janë 3 (tri) të cilat kryhen rreth përfundimit të çdo periudhe.

Planifikimi i orëve mësimore bëhet vjetor (sintetik- bëhet ndarja totale e orëve) si edhe në bazë periudhash tre mujore (analitik- trajtohen temat për çdo orë mësimi).

## **UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre shërben për zhvillimin gjuhësor të nxënësve dhe konsolidimin e kompetencave kyçe dhe ato të lëndës.

Mësuesit duhet të përditësojnë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësi dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë i suksesshëm dhe aktiv në jetën e përditshme dhe botën e punës. Metoda, strategji dhe teknika të tilla si: diskutim për njohuritë paraprake, diagramë piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen, puna në çift ose në grup etj., shërbejnë si nxitje për nxënësin dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Përfaqësja ndaj metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies duhet të jetë shumë e gjerë dhe të paraqesë të gjitha mundësitë në mënyrë të qartë dhe transparente duke

shmangur dogmatizmin. Mësuesi duhet të përdorë ato metoda që e ndihmojnë atë më shumë të arrijë përmbushjen e qëllimit final që është plotësimi i nevojave të nxënësit për t'u bërë një zotërues i mirë i gjuhës.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

### **Mësimdhënie me në qendër nxënësin**

Nxënësi është në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësit. Nxënësit e një klase nxënë në mënyra të ndryshme: disa individualisht ose në grup, të tjerë nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur ose me anë të mjeteve të ndryshme didaktike. Përpos kësaj, lënda e gjuhës së huaj kërkon që nxënësi të nxëjë konceptet, të zotërojë shprehjet dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësit dhe nevojat e nxënësit. Qëllimi i çdo strategjie të mësimdhënies është që çdo nxënës të mësojë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

### **Të mësuarit bashkëveprues**

Mësuesit sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarin bashkëveprues. Nxënësi gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh motivohet të punojnë me nxënësit e tjerë. Detyrat e përbashkëta i sigurojnë nxënësit më shumë kohë për të komunikuar dhe për të ndarë përvojat e tij me pjestarët e tjerë të grupit. Puna në grupe nxit respektin dhe tolerancën ndaj mendimit të tjetrit si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për ndarjen e përgjegjësive dhe punës.

Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet duke forcuar më shumë lidhjen midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës.

### **Integrimi**

Veprimtaritë gjuhësore si: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuptimplota mes tyre. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku për t'a bërë nxënësin të aftë të komunikojë dhe të



përdorë njohuritë e marra në situatë të njohura dhe të panjohura për të dhe të zhvillojë aftësitë e tij të lexuarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të shkruarit.

### **Proçesi i rimarrjes së njohurive**

Aftësitë dhe shkathtësitë, njohuritë rreth sistemit gjuhësor dhe llojet e ndryshme të teksteve zhvillohen duke u rishikuar çdo vit. Kjo arrihet duke kaluar nga e njohura tek e panjohura dhe nga më e thjeshta te më e vështira. Temat dhe njohuritë do të rimerren në mënyrë të hollësishme dhe ciklike në fazë të njëpasnjëshme të programit mësimor. Kjo mundëson që nxënësi të përparojë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

### **Situata e të nxënit**

Mësuesi duhet të parashikojë situatë të nxëni që të realizojë gjatë një ose disa temave mësimore. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale. Kjo mund të zgjasë një ose disa orë mësimi. Këto situata ndihmojnë që nxënësi t'i përdorë njohuritë e marra në jetën e tij të përditshme pa vështirësi dhe në interes të tij.

Pavarësisht metodave të përdorura mësuesi duhet të ketë parasysh që nxënësi ka fituar:

- ) kompetencat e duhura;
- ) aftësinë për t'i përdorur këto kompetenca;
- ) aftësinë për të përdorur strategjitë e duhura në vënien e kompetencave në veprim.

## **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

Vlerësimi i nxënësit është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencash. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënit, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësit (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësit në përmbushjen e kompetencave kyçe dhe ato të programit të lëndor për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përzgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet pasur parasysh:

- )] përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- )] përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e formimit dhe konsolidimit të kompetencave;
- )] përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë di aktualisht nxënësi;
- )] besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet e tyre.

Tradicionalisht, tre koncepte konsiderohen nga më themelorët në vlerësim: vlefshmëria, besueshmëria dhe të qëniti vlerësim i realizueshëm. Mësuesi duhet të ketë parasysh që në vlerësim të jetë i paanshëm dhe transparent.

Vlerësimi i nxënësit ndahet në tre tipa kryesorë:

**Vlerësimi diagnostikues** që zakonisht kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që ka nxënësi rreth asaj për të cilën do të zhvillohet mësimdhënia gjatë vitit shkollor. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikatat e mësimdhënies dhe mësimnxënies në mënyrë që të përcaktohen strategjitë e të ardhmes. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

**Vlerësimi formues** ose i vazhdueshëm është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit, prindërit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënit. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit. Ky vlerësim mund të jetë edhe me simbole, komente etj.

**Vlerësimi përmbledhës** ose përfundimtar kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e fëmijëve të tyre, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve si dhe për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të nxënësve.

Gjatë zbatimit të programit nxënësit duhet t'i jepet mundësia të punojnë individualisht, në çift ose në grup për kryerjen e detyrave të dhëna dhe përmbushjen e kompetencave të lëndës dhe atyre kyçe. Në çdo rast mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënësi, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota në regjistër për secilën prej tyre. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave në klasë dhe jashtë klase.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Këto vlerësime bëhen në mënyrë të alternuar me njëri-tjetrin për t'i dhënë mundësi mësuesit të bëjë një vlerësim të saktë dhe të mirëpeshuar për të gjitha veprimtaritë gjuhësore. Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së nxënësve dhe mësimdhënies.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Praktikën e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve: ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

**Vetëvlerësimi** është element i rëndësishëm në të mësuarin e gjuhës së huaj. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e nxënësit në vazhdimësi. Gjatë vetëvlerësimit në procesin mësimor ndiqen këta hapa:

- ) mësuesi diskuton me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë;
- ) nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte dhe më pas mësuesi dhe nxënësi bëjnë komentin përfundimtar;
- ) nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe duke marrë role të ndryshme, madje ndonjëherë dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit;
- ) nxënësit mban shënim arritjet e tij duke përdorur edhe gjuhën amtare;
- ) mësuesi bisedon me nxënësit individualisht dhe i tregon arritjet;
- ) nxënësi cakton objektivat për të ardhmen;

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të mësuarit dhe i jep mundësi të caktojë objektiva për të ardhmen.

Vetëvlerësimi realizohet gjatë punës me portofolin e gjuhëve.

### **Vlerësimi me portofol lëndor**

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor, kontributeve dhe arritjeve të tij në gjuhën që po mëson, për punën individuale dhe në grup, krijmtarinë, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjerët.

Portofoli gjuhësor ka dy funksione: a. raportues dhe b. pedagogjik

Ai përbëhet nga tri pjesë:

- a. **Pasporta gjuhësore** ku nxënësi regjistron nivelet gjuhësore, kualifikimet dhe përvojat ndërkulturore.
- b. **Biografia gjuhësore** ndihmon nxënësin të rregjistrojë dhe të reflektojë mbi progresin e tij gjuhësor.
- c. **Dosja** e cila mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore, çertifikata,

diploma etj.

Për informacion të mëtejshëm mbi vlerësimin mësuesi i referohet udhëzimeve përkatëse.